



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:075568

Datë: 05.09.2019

Numri i dokumentit: 00495141

**P. nr.99/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.D. nga Suhareka, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.147/19 të datës 05.02.2019, në shqyrtimin fillestar gjyqësor, të mbajtur më datë **28.08.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj si dhe te akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **N.D.** nga Suhareka, i biri i A. dhe i nënës H. e gjinisë P., data e lindjes...,në Suharekë, ka të kryer shkollimin universitar, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, numër personal...

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

-me dt. 22.01.2019, rreth orës 13:45 min, në Gjakovë, Rr. "S.", pikërisht në spitalin Rajonal "I.G." në Gjakovë, derisa ishte fjalosur me punëtorin e sigurimit të spitalit, gjatë kontrollimit nga ana e policisë në gjepin e xhaketës në një pako të cigareve "Lucky Strike", në kundërshtim me nenin 9 dhe 4 të Ligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope nr.02/L-128, e duke e ditur se ka të bëjë me substanca narkotike e duke mos poseduar leje nga organi kompetent, të akuzuarit i është gjetur një cigare "Joint", e mbushur me substancën në formë bari, ngjyrë e gjelbër, substancë narkotike e llojit "Marihuanë", në peshë neto 0.70+- 0.0001 gram, sipas Raportit të ekspertimit nga Agjensioni i Kosovës për Forenzikë AKF/2019-0359/2019-319 i datës 30.05.2019, substanca është sekuestruar dhe gjendët në stacionin policor në Gjakovë.

**-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2 të KPRK-ës,**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,41,43,46,73 të KPRK-ës, dhe nenit 275/2 të KPPK-es, dhe nenit 365 te KPPK-së te akuzuarit i shqipton:

**DËNIM ME GJOBË**

Me dënim me gjobë në shumën prej **300 (treqind)** euro, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së ,atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **15 (dymbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,00-€(njëzetë)euro**.

Detyrohet i akuzuari që ti paguajnë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30,00.-€**, në afat prej **15 ditësh**, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### **MARRJA E SENDEVE**

Konfiskohet substanca narkotike e llojit kanabis (marihuanë) me peshë neto prej 0.70+-0.0001 gram, që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me dt. 22.01.2019 dhe e njëjta të asgjësohet.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.147/19 të datës 05.02.2019, ka akuzuar të akuzuarin N.D. nga Suhareka, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2 të KPRK-ës, duke propozuar që i njëjti të shpallet fajtor të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale si dhe konform nenit 62 par.1pika 2.7 e lidhur me nenin 69 të KPRK-ës, të përcaktohet dënimi plotësues që substanca e sekuestruar narkotike e sekuestruar të konfiskohet përherë dhe të bëhet asgjësimi i saj.

Gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor të mbajtur me dt. 28.08.2019, prokurori i shtetit Anton Hasanaj, lexon aktakuzën PP.nr.147/19 i datës 05.02.2019, me ç ‘rast prokurori deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, por sa i përket sasisë të substancës së sekuestruar në rreshtin e fundit në vend të “në peshë rreth 0.89 gramë” duhet të jetë “pesha neto 0.70+-0.0001 gram, sipas Raportit të ekspertimit nga Agjensioni i Kosovës për Forenzikë AKF/2019-0359/2019-319 i datës 30.05.2019”, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

I akuzuari N.D., lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës, jam penduar për veprën e kryer, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, meqenëse tani jam martuar dhe në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm, pendimin e shpreh në gjykatë për veprën e kryer, premtimin se një veprimi i tillë nuk do të përsëritet, si dhe faktin se nuk kam qenë më parë i dënuar, andaj i propozoj gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, të më shqiptojë një dënim me te butë.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimin të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova të mjaftueshme, i propozoj gjykatës se i akuzuari N.D.te shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari N.D.: me dt. 22.01.2019, rreth orës 13:45 min, në Gjakovë, Rr. "S.", pikërisht në spitalin Rajonal "I.G." në Gjakovë, derisa ishte fjalosur me punëtorin e sigurimit të spitalit, gjatë kontrollimit nga ana e policisë në gjepin e xhaketës në një pako të cigareve "Lucky Strike", në kundërshtim me nenin 9 dhe 4 të Ligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope nr.02/L-128, e duke e ditur se ka të bëjë me substanca narkotike e duke mos poseduar leje nga organi kompetent, të akuzuarit i është gjetur një cigare "Joint", e mbushur me substancën në formë bari, ngjyrë e gjelbër, substancë narkotike e llojit "Marihuanë", në peshë neto 0.70+- 0.0001 gram, sipas Raportit të ekspertimit nga Agjensioni i Kosovës për Forenzikë AKF/2019-0359/2019-319 i datës 30.05.2019, substanca është sekuestruar dhe gjendët në stacionin policor në Gjakovë.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban propozim akuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPP, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale si dhe faktin se është martuar, po ashtu është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, të cilat rrethana ndikuan që Gjukata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shumë prej **300 (treqind) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej **30 ditësh**, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 të KPRK-së dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe se ky sanksion do të ndikoj tek e akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike të llojit kanabis (marihuanë), me peshë prej me peshë neto prej 0.70+- 0.0001 gram ,që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me dt. 22.01.2019 ,u murr komform nenit 275 par.5 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7 nenit 69 te KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr. 99/19 më datë 28.08.2019**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**ËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh** , nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:075568  
Datë: 05.09.2019  
Numri i dokumentit: 00495141